



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.260/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjorbë, në shumë prej 300.00 (*treqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 19.10.2017 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Adem Shabanaj nga radhët e LVV-së, ka vendosur pano reklamuese në pronë publike, përkatësisht në Pyll, gjë e cila sipas tyre është në kundërshtim me Rregulloret dhe Ligjet, të janë të aplikueshme në vendin tonë. Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.10.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), thekson se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, Adem Shabanaj pa dijenin e Qendrës së LVV-së, ka vendosur atë pllakat reklamuese në lokacionin e përmendur në ankesë. Po ashtu në përgjigje LVV - Qendra në Prizren informon PZAP-in se me rastin e kandidimit për Kuvend Komunal, LVV dhe kandidati në fjalë kanë nënshkruar një marrëveshje që në rast të shkeljes së legjislacionit zgjedhor në fuqi, përgjegjësinë e mban vetë kandidati, dhe më tej LVV kërkon nga PZAP-i që të merë për bazë këtë marrëveshje. Përgjigjes në ankesë LVV i ka bashkangjitur marrëveshjen me kandidatin Adem Shabanaj si dhe foto ku shihet se është bërë përmirësimi i shkeljes.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstattoj se :

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografia e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar se Adem Shabanaj, kandidat për anëtar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik LVV, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, kandidati në fjalë ka vendosur pano reklamuese në hapësirë publike, përkatësisht në Pyll, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastin: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se LVV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e tij, ka bashkangjitur dëshmi ku shihet se është bërë evitimi i shkeljes. Ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi, se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c), nenit 117.2 dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

ZL.Anr.260/2017 me datë 20.10.2017



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së*